

STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "MAXIMO DESAROLLO LIMITED ALBANIA"

Sot, më date 28.02.2022 unë i poshtë shënuari:

Z.Nicola RIGGI, shtetas Italian, i biri i Biagio lindur më 30 Qershor 1969 në Sassuolo (MO), Itali dhe banues në Rruga: Via Petraca 32, Sant'Agata Sullsanterno, Itali i identifikuar nga Pasaporta me Nr YA7549740

Kapitulli I EMRI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 Forma

1. Shoqëria "MAXIMO DESAROLLO LIMITED ALBANIA" Sh.p.k. është themeluar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe aktiviteti i saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 2 Emri

1. Emri i Shoqërisë është "MAXIMO DESAROLLO LIMITED ALBANIA" Sh.p.k.

Neni 3 Logo

Neni 4 Objekti

Objekti i shoqërisë është:

- Shërbim i këmbimit të valutës
- Shërbim i transferimit të valutës
- Shërbime të ndryshme të valutës kripto
- Shërbime të ndryshme financiare
- Veprimtari të agentit për transfertë valute dhe kripto valute në emër dhe për llogari të një subjekti financiar
- Siguracione
- Shërbime të transferimit të valutës dhe kriptovalutës për shoqëritë jo bankë
- Shërbimi të këmbimit të kripto valutës
- Shërbime të blerjes dhe shitjes së kriptovalutës
- Krijimi dhe menaxhimi i portofolove të kriptovalutës për pale të treta

Neni 5 Selia

1. Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në: **Rruga "Myslym Shyri", Pallati 48, Shkalla 1, Kati 2, Zyra 15, Njësia Bashkiake Nr 10, Tiranë.**
2. Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vëtëm) mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë në një vend tjetër, apo mund të vendosë hapjen e degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë kudo, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 6 Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është e pa kufizuar.

Kapitulli II

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 7 Kapitali

1. Kapitali i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Neni 8

Kuotat e kapitalit dhe zotërimi i tyre

1. Kapitali është i përbërë nga 1 (një) kuotë kapitali, me vlerën nominale prej prej 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Neni 9

Zmadhimi i kapitalit

1. Asambleja e Përgjithshme (ortaku i vetëm) mund të rrisë pa kufi kapitalin e Shoqërisë.
2. Administratori njofton për regjistrim, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, vendimin për zmadhimin e kapitalit. Vendimi publikohet edhe në faqen e internetit të Shoqërisë.
3. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 10

Zmadhimi i kapitalit me aktive të Shoqërisë

1. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.
2. Pjesa e rezervave, që shkon përtej 1/10 së kapitalit të regjistruar, si dhe fitimet e pashpërndara mund të kalohen në kapitalin fillestar.
3. Rezervat dhe fitimi i pashpërndarë nuk mund të kalohen në kapitalin bazë, nëse bilanci i vitit paraardhës rezulton me humbje.

Neni 11

Zvogëlimi i kapitalit themeltar

1. Asambleja e përgjithshme (ortaku i vetëm) mund të reduktojë kapitalin themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
2. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratorët. Ky vendim publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.
- 3.

Neni 12

1. Transferimi i kuotave të kapitalit dhe e drejta e parablerjes .Kuotat e kapitalit mund t'u transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht, vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (ortakut të vetëm).

Neni 13

Pasojat e kalimit të kuotave

1. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

Kapitulli III

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRIMI, KONTROLLI

Neni 14

Të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e Përgjithshme (ortakut i vetëm) është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 15 Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga Administratori. Funksion i cili do të kryehet nga ortaku i vetëm **Z. Nicola Riggi**, për një mandat 5 vjecar, nga 28.02.2022 deri më 27.02.2027 me të drejtë ripërtëritjeje.

2. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
 - a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojë Shoqërinë;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
 - c) përgatisë dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
 - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
 - ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 16 Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

1. Administratori detyrohet të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi. Administratorët përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim që vjen në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale.

Kapitulli IV SHPËRNDARJA E FITIMIT

Neni 17 Shpërndarja e fitimeve

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë.
2. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

Kapitulli V

PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 18

Shkaqet e prishjes së shoqërisë

1. Shoqëria priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk kryen veprimtari tregtare për dy vjet;
- d) me vendim të gjykatës;

Dispozita Kalimtare

Neni 19

Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe.

Lexuar, nënshkruar

Nicola Riggi
Ortak i Vetëm

